SHFK “SABEDIN BAJRAMI” KAMJAN

PROGRAMA VJETORE
për punë në vitin shkollor 2026/2027



Gusht 2026, Kamjan

Në bazë të ligjit për arsim fillorë (Gazeta zyrtare e RMV-së me nr.161/2019; 229/2020 dhe 03/2025)**„SABEDIN BAJRAMI”** Kamjan në mbledhjen e këshillit mbajtur më 17.08.2026 për punën e shkollës për vitin shkollor 2026/2027 sjellë këtë:

PROGRAMA VJETORE

Shkolla fillore SHFK “Sabedin Bajrami” Kamjan me dy shkollat periferike në fsh.Siniçan dhe në fsh.Sellarcë e Epërme për vitin shkollor 2026/2027 do të punojnë reafirmimin e vlerave të cilat janë të lidhura me qëllimet edukativo-arsimore, puna e shkollës do të bazohet në ligjin për arsimin fillortë R.sëMaqedonisë së Veriut dhe në metodat bashkëkohore didaktiko-metodike.(teori dhe praktikë).

Në këtë drejtim do të angazhohet, që të krijojë kushte sa më të mira për nxënësit dhe arsimtarët (tëpunësuarit), për përmirësimin e suksesit të nxënësve si dhe afirmimi i shkollës në nivel komunal dhe më gjerë. Gjatë kryerjes së veprimtari së së vet themelore, shkolla do të angazhohet sa më intenzivisht në përparimin e zhvillimit të mësimit bashkëkohor, duke përcjellë të gjitha seminaret dhe projektet të paraparanga MASH, BZHA dhe asociacione të ndryshme që do të ndikojnë në ngritjen e nivelit të diturive të arsimtarëve dhe nxënësve.

.

Përmbajtja

PROGRAMAVJETORE 2
1.Letërnjoftimi i shkollës 5
1.2 Vendndodhja 6
Organizimi i punës edukativo-arsimore në shkollë 13
2. Misioni i shkollës 13
3. Vizioni i shkollës 13
4. Nevojat për ndryshime në jetën dhe punën e shkollës 14
5.Qëllimet dhe detyrat zhvillimore 16
6. Detyra dhe aktivitete 18
7.Organizimi i punës edukativo-arsimore 19
7.1 MËSIMI 19
7.1.1 Mësimi i rregullt 19
7.1.2 Mësimi zgjedhor. 19
7.1.3 Mësimi shtues 20
7.1.4 Mësimi plotësues 20
7.1.5 Mësimi vazhdues 20
7.2. Aktivitetet jashtëmësimore 21
Programa për punë të A.L.N-Sesioni i Dramës 22
Programa për punë të A.L.N – Sesioni i Sportit 23
Programa për punë të A.L.N – Sesioni Recitues 25
Programa për punë të A.L.N-të BTP-ës 25
Programa për punë të A.L.N- Matematicientëve 26
Programa për punë të A.L.N – Gjeografët e rinj 28
Programa për punë të A.L.N – Art.Figurativ 29
Programa për punë të A.L.N – Sesioni i Historisë 30
Garat shkollore. 31
Programa për punë prodhuese dhe punë të tjera të dobishëme shoqërore 31
Bashkësia nxënësve 31
*Përmbajtja e aktiviteteve 32
7.3. Kujdesi për shëndetin e nxënësve 32
7.4. Bashkëpunimi me bashkësitë vendore 33
Programa për organizimin e prindërve 33
Programa për punë të këshillit të prindërve në kuadër të shkollës 34
Mbledhjet prindërore 35
Programa për mbledhje prindërore me aktivitete konkrete 35
Bashkëpunimi me entet dhe institucionet edukativo-arsimore 37
Bashkëpunimi me rininë do të realizohet nëpërmes këtyre formave 37
Bashkëpunimi me institucionet kulturore dhe SH.K.A-të 37
7.5.Ndjekja, vlerësimi dhe avansimi i punës edukativo-arsimore 38
Planifikimi dhe përgatitja e arsimtarëve për zhvillimin e mësimit. 38
PROGRAMI VJETOR I PUNËS SË SHËRBIMIT PROFESIONAL TË SHKOLLËS 53
PROGRAMI VJETOR I PUNËS SË SHËRBIMIT PROFESIONAL -PEDAGOG 53
1. Hyrje 54
1. Përcjellja e planifikimit përmes monitorimit të mësimit 54
2. Puna këshilluese konsultative me nxënësit, mësimdhënësit dhe prindërit 54
3. Puna analitike hulumtuese 55

4. Ngritja profesionale e kuadrit edukativ dhe arsimor 55

5. Evidencë e dokumentacionit pedagogjik 55

6. Përcjellja e procesit edukativ dhe arsimor në shkollë 55
7.1. Plani global i punës 55
PLANI VJETOR I PUNËS SË SHËRBIMIT PROFESIONAL TË SHKOLLËS – 2026/27 56
7.2. Plani operativ i punës 56
PROGRAMA E PUNËS PËR BASHKPUNËTOR PROFESIONAL PSIKOLOG v.sh 2026/27 58
Fusha 1: Planifikimi dhe përgatitja e Psikologut 58
Fusha 2: Pregatitja, planifikimi dhe programet në nivel shkolle 58
Fusha 3: Punë këshilluese me nxënësit 59
Fusha 4: Puna me nxënës me nevoja të veçanta arsimore 59
Fusha 5: Puna me studentë të talentuar 59
Fusha 6: Puna me nxënës me vështirësi në të nxënë 60
Fusha 7: Regjistrimi i nxënësve dhe formimi i paraleleve 60
Fusha 8: Monitorimi i suksesit dhe progresit të nxënësve në aktivitetet kurrikulare dhe jashtëshkollore 60
Fusha 9: Puna për orientimin profesional 61
Fusha 10: Bashkëpunimi me prindërit 61
Programa për punën e udhëheqësit të paraleles kl. V-ta 62
Programa për punën e udhëheqësit të paraleles Kl-VII 64
Programa për punë të udhëheqësit të paraleles të klasave të VIII dhe IX 65
Programa për punë të Këshillit të arsimtarëve 68
Programa për punë të Këshillit të klasave 69
Programa për punë të aktiveve profesionale 70
Planifikimi i punës edukativo-arsimore në shkollë 71
Shëtitjerekreativo-sportivenjë ditorenëPranverë 75
1. PROGRAMPËRORGANIZIMINEEKSKURSIONITNJËDITORPËRKLASËNE I-III 76
3.PROGRAMPËRORGANIZIMINEEKSKURSIONITNJË DITORPËRKLASAT VI,VII,VIII,IX 78
Orari i ziles së shkollës paradite dhe pasdite 86
Festat shtetrore 2026/2027 87
ESARUED–Udhëzimepune–Administratorishkollor 88
Hapjaevitit shkollor ngaadministratoriiMASH it 88
Detyrat eadministratorit tëshkollës 88
Shpërndanëparalele 88
Detyra të tjera të administratorit të shkollës 88
Emërodrejtor. 89
Autorizime dhekufizimeshtesë 89
Vaksinimi i nxënësve për vitin Shkollor 2026/2027 90
Plani Operativ i EIN (Ekipi i Tim Inkluziv me nxënës) 90
PROGRAMA PËR PUNËN E KËSHILLIT TË SHKOLLËS PËR VITIN SHKOLLOR 2026/27 92
PROGRAMA PËR ORIENTIM PROFESIONAL TË NXËNËSVE…….94

1. Letërnjoftimi i shkollës

Shkolla fillore ”Sabedin Bajrami” si shkollë tetëvjeçare filloi me punë në vitin shkollor 1979/1980 në kuadër të shkollës qendrore të Bogovinës, kurse prej vitit 1987 nga ana e Ministrisë njihet si shkollë qendrore dhe të njejtin vit kësaj shkolle i bashkangjiten edhe nxënësit e fshatit Sedllarcë e Epërme.

1 **Të dhënatë përgjithshme për shkollën**

Emri i shkollës	**Sabedin Bajrami**
Adresa ,Komuna,Vendi	Rr. 101 PN F. Kamjan
Telefon	044-394-294
Web-faqe	Sabedinbajrami.edu.mk
emaili	ou-sabedinbajrami-kamenjane-bogovinje@schools.mk
Viti i themelelimit	1979/80
Verifikimi–numrii aktit	16-289/2
Gjuha mësimore	Gjuhashqipe
Viti i ndërtimit	1987, 2007 , 2022/23
Tipi i ndërtesës	Ndërtesë e fortë
Shkolla punonnë ndërrime	Po
Paralele të ndara	Siniçan dhe Sellarcë e Epërme
Mënyra e nxemjes së shkollës	Me lëndë djegëse naftë(në Siniçan dhe Sellarcë e Epërme me lëndë djegëse peleti)
Numri i klasave	33
Numri i paraleleve	44
Numri i ndërrimeve	2 ndërrime në qendër (klasat 6-9para dite;klasat 1-5pasdite) ndërsa në periferike me një ndrim.


1.2 Vendndodhja

Shkolla Fillore “Sabedin Bajrami” ndodhet në pjesën perëndimore të fshatit **Kamjan**, që gjendet në komunën e **Bogovinës**, në pjesën veriperëndimore të **Republikës së Maqedonisë së Veriut**.

Fshati Kamjan shtrihet në një zonë kodrinore në ultësirën e rrafshit të Pollogut, përreth lumit të vogël që kalon në afërsi të shkollës dhe është i rrethuar nga terren i larmishëm – me zona të ndërtuara urbane dhe hapësira të gjelbra natyrore.

Shkolla është e vendosur afër kufirit midis zonës urbane të fshatit dhe terrenit kodrinor në perëndim. Ajo shtrihet pranë rrugës lokale që lidh qendrën e Kamjanit me pjesët periferike, dhe është një pikë qendrore e rëndësishme për komunitetin, jo vetëm në aspektin arsimor, por edhe si orientim hapësinor në vendbanim.

Në veriperëndim të shkollës ndodhen kodrat dhe pyjet që shtrihen drejt maleve të Sharrit, ndërsa në jug dhe lindje shtrihen zonat e banuara me shtëpi të dendura dhe biznese lokale. Rruga kryesore që kalon përmes Kamjanit ndodhet pak metra larg nga shkolla, duke e bërë atë lehtësisht të arritshme nga pjesa më e madhe e banorëve të fshatit.



PERDHESA



KATI 1


LEGJENDA
HYRJA KRYESORE
KLASAT
ADMINISTRATA
KOMUNIKIMI VERTIKAL
DEPOJA
KORRIDORI
HAPSIRAT SANITARE

Klasa	Nr.Nx.Gjithsejt	Meshkuj	Femra
I-1	25Lirie Idrizi	17	8
I-2	26 Mereme Hasani	18	8
I-3	9 Mevlude Kica	8	1
I-4	15 Nesfije Deari	8	7
Gjithsej	**75**	**51**	**24**
II-1	13 Behije Rexhepi	6	7
II-2	12 Fatmire Aliu	6	6
II-3	11 Alberta Alimi	6	5
II-4	11 Driton Bajrami	7	4
II-5	7 Valmira Amzai	5	2
Gjithsej	**54**	**30**	**24**
III-1	12 Arlinda Deari	4	8
III-2	12 Isnije Mirta	6	6
III-3	13 Zumreta Saiti	9	4
III-4	6 Ylldita Veliu	4	2
III-5	12 Teuta Bajrami	5	7
Gjithsej	**55**	**28**	**27**
IV-1	14 Lumturije Bakiu	8	6
IV-2	17 Luljeta Musliu	8	9
IV-3	18 Nazlie Dervishi	9	9
IV-4	11 Valbona Memedi	5	6
IV-5	11 Fisnike Iseni	4	7
Gjithsej	**71**	**34**	**37**
V-1	18 Mersije Jahjai	10	8
V-2	18 Hurije Sali	10	8
V-3	18 Xhezmi Rustemi	11	7
V-4	7 Latife Avziu	5	2
V-5	18 Artime Sinani	8	10
Gjithsej	**79**	**44**	**35**

Cikli i lartë

Klasa	Nr.Nx.Gjithsejt	Meshkuj	Femra
VI-1	12 Sadife Dauti	6	6
VI-2	10 Qendresa Sallai	5	5
VI-3	13 Hirmiz Ferati	9	4
VI-4	12 Asmir Sallai	6	6
VI-5	9 Muhamet Ismaili	6	3
Gjithsej	**56**	**32**	**24**
VII-1	12 Liridona Ferati	7	5
VII-2	12Valona Beadini	7	5
VII-3	17Xheneta Asani	9	8
VII-4	12 Nadije Idrizi	9	3
VII-5	17 Xhemile Selmani	9	8
Gjithsej	**70**	**41**	**29**
VIII-1	20 Shyrete Rustemi	10	10
VIII-2	16 Medina Abazi	8	8
VIII-3	15 Bekim Ziberi	8	7
VIII-4	15 Bexhet Zulfi	6	9
VIII-5	14 Idriz Ismaili	10	4
Gjithsej	**80**	**42**	**38**
IX-1	13 Aferdita Murati	4	9
IX-2	14 Zeqije Ismaili	4	9
IX-3	14 Merita Ajruli	8	6
IX-4	12 Safet Imeri	6	6
IX-5	13 Adisa Sherifi	4	9
Gjithsej	**66**	**27**	**39**

PARALELET	Numrii përgjithshem i nxënësve	Meshkuj	Femra
I – V	**334**	**187**	**147**
VI – IX	**272**	**142**	**130**
I – IX	**606**	**329**	**277**

SHFK ”Sabedin Bajrami” në vitin shkollor 2026/2027 do të pranojë të gjithë fëmijët nga 6 deri 15 vjet dhe ate prej kl. I-IX-të.

Numri i përgjithshëm i nxënësve në vitin shkollor 2026/2027 është 606 prej të cilëve 334 në ciklin e ulët dhe 272 në ciklin e lartë, të cilët do të sistemohen në 44 paralele.

Për realizimin e procesit edukativo-arsimor është siguruar kuadër adekuat, u angazhuan 64 arsimtarë edhe ate 33 në ciklin e ulët dhe 31 arsimtarë lëndor. Të gjithë arsimtarët në ciklin e ulët dhe në ciklin e lartë janë me kualifikim adekuat.

Nr. Pasqyra dhe struktura e kuadrit arsimor për vitin shkollor 2026/27.

N.r	Emri dhe mbiemri	Shkolla e kryer	Lënda	Përvoja
1.	Fatmire Aliu	F. P. Grupi klasor	Mësimi klasor I-1	26
2.	Mereme Hasani	F. P. Grupi klasor	Mësimi klasor I-2	33
3.	Mevlude Kica	F.Pedagogjik	Mësimi klasor I-3	18
4.	Nesfije Deari	F. Pedagogjik	Mësimi klasor I-4	14
5.	Behije Rexhepi	F. Pedagogjik	Mësimi klasor II-1	11
6.	/	F. Pedagogjik	Mësimi klasor II-2	
7.	Alberta Alimi	F.Pedagogjik	Mësimi klasor II-3	21
8.	Driton Bajrami	F.Pedagogjik	Mësimi klasor II-4	20
9.	Valmira Amzai	F.Pedagogjik	Mësimi klasor II-5	6
10.	Arlinda Deari	F.Pedagogjik	Mësimi klasor III-1	6
11.	Isnije Mirta	F. Pedagogjik	Mësimi klasor III-2	30
12.	Zumreta Saiti	F. Pedagogjik	Mësimi klasor III-3	31
13.	Ylldita Veliu	F.Pedagogjik	Mësimi klasor III-4	25
14.	Teuta Bajrami	F. Pedagogjik	Mësimi klasor III-5	9
15.	Lumturije Bakiu	F. Pedagogjik	Mësimi klasor IV-1	29
16.	Luljeta Musliu	F. Pedagogjik	Mësimi klasor IV-2	8
17.	Nazlie Dervishi	F. Pedagogjik	Mësimi klasor IV-3	13
18.	Valbona Memedi	F. Pedagogjik	Mësimi klasor IV-4	20
19.	Fisnike Iseni	F. Pedagogjik	Mësimi klasor IV-5	14
20.	Mersije Jahjai	F P - grupi klasor	Mësimi klasor V-1	7
21.	Hurije Sali	F.Pedagogjik	Mësimi klasor V-2	5
22.	Xhezmi Rustemi	F. Pedagogjik	Mësimi klasor V-3	40
23.	Latife Avziu	F. Pedagogjik	Mësimi klasor V-4	25
24.	Artime Sinani	F. Pedagogjik	Mësimi klasor V-5	13
25.	Shyrete Rustemi	F.Albanologjik	Gjuhë Shqipe	23
26.	/	F.Albanologjik	Gjuhë Shqipe	

	Xhemile Selmani	F.Albanologjik	Gjuhë Shqipe	23
28.	Hirijet Nuredini	F.Albanologjik	Gjuhë Shqipe	23
29.	Shukrane Koska	A.P.Gju.shq-maq.	Gjuhë Maqedone	36
30.	Elifije Hoxha	A.P.-Gr.klasor	Gj.Maqedone	38
31.	Shpëtime Abazi	F. Gj. Maqedone	Gj. Maqedone	9
32.	Vjollca Avzija	F.F. Gj.Angleze	Gjuhë Angleze	17
33.	Idriz Ismaili	F.F.Gj.Angleze	Gjuhë Angleze	22
34.	Dashmire Kadriu	F.F. GJ. Angleze	Gjuhë Angleze	25
35.	Ibe Elezi	F.F. GJ. Angleze	Gjuhë Angleze	19
36.	Ermine Garipi	F.F. GJ. Angleze	Gjuhë Angleze	18
37.	Merita Ajruli	F.F. GJ Angleze	Gjuhë Angleze	27
38.	Adisa Sherifi	F. Biologji	Shkencat e Natyrës	8
39.	Xheneta Asani	F.F.Gj. Gjermane	Gj.Gjermane	15
40.	Sehade Nuredini	F.F.Gj. Gjermane	Gj.Gjermane	16
41.	Rahim Aliu	A.P.- Matematikë	Matematikë	32
42.	Sadife Dauti	A.P.- Matematikë	Matematikë	12
43.	Merzika Zurapi	A.P.- Matematikë	Matematikë	13
44.	Safet Imeri	A.P.- Matematikë	Matematikë	28
45.	Qëndresa Aliu	F. Fizikë	Fizikë	11
46.	Suada Bexheti	A.P. Kimi	Kimi	1
47.	Zeqie Ismaili	A.P. Biologji	Biologji+Shkenca	15
48.	Nadie Idrizi	F. Biologjisë	Biologji	16
49.	Asmir Sallai	F.F.-Histori	Histori	15
50.	Liridona Ferati	A.P. Histori+Shoqeri	Histori	4
51.	Bexhet Zulfiu	F.M.K.-Gjeografi	Gjeografi	7

	Hirmize Ferati	F.M.K.-Gjeografi	Gjeografi+Shkenca+Shkathtesi	3
53.	Medina Abazi	F.SH.Kompjuterike	Informatikë+BAT	17
54.	Jehona Arifi	F. Informatikë	Informat.+ Progra	10
55.	Asllan Ismaili	A.P.Ed.fizike	Arsim fizike-shënd	38
56.	Amet Aliu	A.P.Ed.fizike	Arsim fizike-shënd	15
57.	Bekim Ziberi	F.i Kul.Fizike	Arsim fizike-shënd	18
58.	Afërdita Murati	F. Arteve	Arsim figurativ	25
59.	Agron Idrizi	A.P.Grupi Muzikës	Arsim muzikorë	40
60.	Muhamed Ismaili	F.Shkencave Islame	Njohja e religjioneve	20
61.	Zembrej Huseini	A.P.Ed.fizike	Arsim fizike-shënd	5
62.	Asmir Ramadani	A.P.Ed.fizike	Arsim fizike-shënd	4
63.	Valona Beadini	A.P.Matematike	Matematike	4
64.	Elmaz Sinani	A.P.E d.fizike	Arsim fizike-shënd	3

Shkolla fillore komunale "Sabedin Bajrami" veprimtarinë edukativo-arsimore e realizon në tre objekte shkollore edhe atë: një në shkollën qendrore në fshatin Kamjan, dy në shkollën territoriale në F. Sedllarcë e Epërme dhe një në F.Siniçan. Në to janë të përfshirë të gjithë fëmijët nga mosha 6 deri 15 vjeçare.

Të gjitha objektet i plotësojnë kushtet për procesin edukativo-arsimor, kemi në të tre objektet 44 klasa, 3 zyra për arsimtarë si dhe 6 kabinete (Dy kabinete per Informatikë, Muzikë, Kimi&Fizikë, Gjuhë Anglezedhe Art Figurativ).

Sa u përket mjeteve materiale, ata sigurohen nga pushteti lokal – Komuna. Gjithashtu një ndihmesë të madhe e kanë dhënë edhe një sërë projektesh për "Modernizimin e Arsimit".

Organizimi i punës edukativo-arsimore në shkollë

Programa vjetore për punë në shkollë për vitin shkollor 2026/27 është e përgatitur ashtu që në të njejtën janë të gërshetuara detyra konkrete programore me dinamikë konkrete të realizimit të detyrave dhe realizatorët në të gjitha lëmitë dhe do të fillojë nga qëllimi, detyrat dhe parimi elementar për organizimin e punës edukativo-arsimore në arsimin fillor të përmbajtura në dokumentin "Arsimi fillor" Fleta zyrtare 63 neni 75 alineja 1 dhe 2.

ShFK "Sabedin Bajrami" në programën lidhur me orarin dhe shënimin e ngjarjeve të rëndësishme gjatë vitit shkollorë organizojmë këta manifestime:

Java e Festave të Nëntorit (me program festiv më 28 Nëntor, "Dita e flamurit")
Java e Arsimit Shqip (me program fesiv për 7 Marsin "Dita e Mësuesit" dhe "Patronati i Shkollës".
Java Antikorrupsion – 7 Dhjetor (Ligjërata në orët e klasës, orët e Arsimit Qytetar, Posterë)
Java e fundit e Marsit – Eko-shkolla – program me aktivitete ekologjike
Java e fundit e Prillit – Olimpiada (gara dhe aktivitete te shumta sportive në sallë)
Festa e Fundvitit – Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve – Panair dhe Shfaqje – 1 Qershor

2. Misioni i shkollës

Shkolla jonë ofron shërbime për mjedis në të cilin nxënësit me kënaqësi të sigurtë dhe të disiplinuar do të përcjellin mësim bashkëkohor, efikas dhe të përshtatur ndaj nevojave dhe intersave të nxënësve, arsimtarëve dhe prindërve duke i respektuar parimet demokratike të shoqërisë.

3.Vizioni i shkollës

Dëshirojmë që shkolla e jonë të ofrojë mundësi për zhvillim dhe përparim të çdo nxënësi. Në shkallë optimale do të respektohet personaliteti i nxënësit, ndërsa paradispozitat dhe aftësitë e nxënësve do të transformohen në shkathtësi për të jetësuar ide dhe projekte.

Si në të gjitha shkollat edhe në shkollën tonë është e nevojshme që në mënyrë permanente të kryhen ndryshimet në procesin edukativo-arsimor. Gjatë përpilimit të programës kemi parasysh një numër të madh ndryshimesh, meqenëse të gjitha ndryshimet nuk mund njëkohësisht të bëhen dhe do të përcaktohemi për ato që janë më me prioritet.

- **Organizimi dhe realizimi i programës, me zbatimin e metodave bashkëkohore, format e punës dhe mjetet mësimore.**

1. Bashkëpunimi në trekëndëshin pedagogjik arsimtar-prind-nxënës.
2. Bashkëpunimi me rrethin: pushteti lokal, familja dhe më gjërë.
3. Kalimi prej mësimit tradicional në metoda bashkëkohore (mësim kabinetik)
4. Bashkëpunimi: arsimtar-arsimtar,arsimtar-nxënës,udhëheqësi-arsimtarë.

- **Zhvillimi dhe përsosja e arsimtarëve**

1. Gj.Shqipe- sipas Konceptit të ri Kl-8
2. Furnizimi me literaturë bashkëkohore
3. Puna me nxënësit me nevoja të veçanta
4. Matematika sipas Konceptit të ri te Kl-8
5. Biologji-Shkenca me KL e 8
6. Kulturë qytetare
7. Përdorimi i kompjuterit (konkretisht: paketa Microsoft dhe burimet e internetit)
8. Historo dhe Gjeografi Kl-8
9. Informatik dhe Ars.teknik KL-8
10. Gj.Maqedone Kl-8

4. Nevojat për ndryshime në jetën dhe punën e shkollës

Shkolla fillore ”Sabedin Bajrami” procesin edukativo-arsimor e kryen tek shkolla qendër në dy ndërrime,në Siniçan dhe Sedllarcë të Epërme vetëm në një ndërrim. Ndërrimii parë fillon prej ora 7:30 dhe ndërrimi i dytë fillon prej ora 13:15. Tëangazhuar janë 64 arsimtarë, Drejtori, Sekretari, Pedagog, Psikolog, bibliotekisti, 2 përgjegjës në shkollat periferike, mjeshtri për mirëmbajtje si dhe 11 pastrues. Kushtet e objekteve janë në gjendje funksionale, por me shumë nevojë për intervenime në infrastrukturë dhe inventar.

Në këtë shkollë procesi edukativo-arsimor kryhet ashtu si që është paraparë me ligjin për arsim fillor, ndërsa tek klasat e para deri në të shtata aplikohet mësimdhënia sipas konceptit të ri, gjithashtu në këtë v.sh për herë të parë fillojmë mësimdhënien me konceptin e ri te KL-VIII.

Shkolla “Sabedin Bajrami” çdo vitë merr pjesë nëpër seminare të ndryshme dhe nëpër gara të ndryshme ku sipas rezultateve të korrura arrin të renditet tek shkollat më të mira. Gjatë vitit shkollor 2025/26 shkolla jonë arriti të kualifikohet në nivel **Republikan në gara me 2 vende të para,2 vende të dyta dhe 3 vende të treta. Në nivel Komunal me 1 vend të parë,6 vende të dyta ,18 vende të treta dhe 12 vende të katërta. Në garat Rajonale 3 vende të para,1 vend të dytë, 1 vend të tretë 9 vende të katërta ,1 vend të pestë dhe 1 vend të gjashtë. Në garat Shkollore me 27 vende të para ,2 vende të treta dhe 1 vend të katërt.**

“Spelling Bee” në Gjuhë Angleze, vend të 1 dhe 3 (17 nxënës ishin pjesmarës) pjesmarrës në garën e shoqatës së fizikantëve të RMV në lëndën e Fizikës, vend të parë në olimpiadën në atletikë ku u shperblyn dy nxënës të trajnuar nga arsimtari ynë i edukatës fizike, gjithashtunjë në vendin e dytë atletik dhe një në vendin e tretë , por i përfaqësuar nga një klub sportivë, vende të para në matematikë dhe futboll dhe vend të tretë në volejboll në garat komunale, vende të para ,i dytë dhe i tretë në garat e poezisë organizuar nga biblioteka e Tetovës.

Anët e mira të shkollës janë:

-Të gjithë arsimtarët kanë kryer kursin për kompjuter dhe internet.
-Shumica e arsimtarëve janë trajnuar për metodat bashkëkohore të punës me nxënës.
-Ekziston bashkëpunimi me pushtetin lokal.
-Bashkëpunimi shkollë –familje.
-Bashkëpunimi shkollë Ispektorat i Arsimit
-Bashkëpunimi shkollë BZHA
-Bashkëpunimi ndërmjet arsimtarëve dhe udhëheqjes së shkollës.
-Klimë e mire bashkëpunimi në mes të arsimtarëve
-Furnizimi i kabineteve me kompjuter bashkëkohor dhe lidhja me internet
- Furnizimi i shkollës edhe me mjete tjera konkretizuese nga lëndët si Kimia, Fizika,
- Biologjia, Arsimi Fizik-shëndetësor, Art Figurativ etj.
-Mësimi kabinetik për lëndët Fizikë, Matematikë, Kimi, Muzikë, Informatikë, gj. Angleze dhe Art Figurativ.
- Te secila klasë është vendosur IT sistemi (projektor, kompjuter),
-Biblioteka e re (e pajisur me lektyra të reja)
-Te salla sportive është e instaluar nxemja qëndrore.

Anët e dobëta të shkollës:

-Pjesërisht mësimi tradicional në ciklin e lartë (KL-IX-ta).
-Ekziston rezistenca te disa arsimtarë ndaj reformave.
- Prezenca e prinderve gjate procesit edukativo –arsimor.
-Mos respektimi i orarit te cikli i ulët Kamjan ndrimi i dytë.
-Puna në dy ndërrime të shkolla qendrore Kamjan.
-Fëmijët me nevoja të veçanta.
-Mungesa e mjetit zyrtar të shkollës për shpërndarje dhe shërbim të tre lokacioneve.
-Mungesë në stafin e udhëheqjes dhe shërbimeve (p.sh. arhivist, defektolog, kopshtar, mirëmbajtës i elektronikës dhe fotokopjues, etj…)

Të gjitha që i përmendëm si anë të dobëta të shkollës janë si prioritet për ndryshime, por sa do të arrijmë është diçka që nuk varet vetëm prej nesh, por prej shumë faktorve: Ministrisë për Arsim dhe shkencë, Byrosë për Zhvillimin e Arsimit, pushtetit lokal dhe nga vetë arsimtarët.

Prej të gjitha këtyre prioritet më i madh është kalimi prej mësimit tradicional në "Konceptin e ri" për të gjitha gjeneratat dhe puna nëpër kabinete gjë që do të mundësonte ngritje të cilësisë së mësimit.

5. Qëllimet dhe detyrat zhvillimore

Gjatë vitit të kaluar shkollor u planifikuan dhe u realizuan disa projekte
- Projekti Marëdhëniet ndëretnike" USAID

- Riskonstruim i shkollës (fasada, çatia, nyje sanitare, hyrja e shkollës e rregulluar për fëmijët me nevoja të veçanta).
- Rrethimi i shkollës, rregullimi i parkut të shkollës.
- Ndërtimi i një klase të re.
- Biblioteka e re
- Vendosja e IT-së nëpër klasa
- Vendosja e nxemjes në sallën sportive
-Rregullimi i korridoreve të shkollës të financuar nga MASH (dyshemeja, lyerja-faza e pare dhe dyert)
- Qendra për inovacione për një të ardhëme të gjelbërt.
- Vendosja e 14 radiatorëve plus në Sh.P.Sedllarcë
- Krijimi i një zyre të re për përgjegjësen në Sh.P në Sedllarcë
- Rregullimi i korridorit me pllaka tek klasa I-2 në Sh.P.Sedllarcë
- Vendosja e kompjuter-projektor për secilën klasë në Sh.P.Sedllarcë
- Zbukurimi dhe lyerja e shkollës e korridoreve të Sh.P.Siniçan
- Vendosja e mbrojtëses e oborrit të Sh.P.Siniçan
-Rregullimi i kabinetit të Informatikës Sh.P.Sinican
-Vendosja e projektorëve në secilën klasë SH.P.Sinican
-Vendosja e ndriçimit në oborrin e shkollës SH.P.Sinican.
-Shtrimi me bekaton i hyrjes dhe parkingut të shkollës në SH.P.Sinican.
-Vendosja e Smart table te KL-III/4
Vendosja e 15 Kompjuterave të rrinjë në shkollësn qendër (5 nga MASH) dhe (10 donacion nga UEJL)
- Vendosja a tablave të basketit në SHFK„Sabedin Bajrami”
-Ndërtimi i kabinetit të Artit Figurativ dhe arkivit të shkollës.
-Vendosja e sistemit të nxemjes në hapsirat e kabinetit dhe arkivit.
-Fillimi i realizimit të projektit „Për një të ardhme të Gjelbërt’’
-Projekt në Lëndën Shkathtesi të jetës Ars.Jehona me nx. e KL/VII (Shqiponja)
-Vendosja e bankave dhe karrigeve në krejt shkollën „Sabedin Bajrami”
-Vendosja e tabelave të bardha nëpër klasa.
-Vendosja e shkafave në çdo klasë për secilin nxënës.
-Ndërtimi i fushës së volejbollit në SH.P.Sellarc.
-Vendosja e televizorave Smart nëpër klasa Sh.P.Sellarc.
- Vendosja e Kamerave në objektin e shkollës SH.P.Sellarc.
-Vendosja e bankave dhe karrigeve të reja (Mariff) për klasat I/5, II/5

Në vitin shkollor 2026/2027detyra prioritare do të jenë:

-Zbatimi i mësimdhënies sipas Konceptit të ri të arsimit me klasat e VIII-ta.
-Lyerja e shkollës brenda.

- Bashkimi i brendëshëm (korridoreve) prej ndërtesës të vjeter në të re në Sh.P.Sedllarc
- Rregullimi i stadionit të Sh.Q.Kamjan
-Projekti-Matematika Hulumtuese
-Projekti "Të mënduarit matematikisht"
-Zbatimi i standardeve të notimit të nxënësve
-Projekti per modernizimin e arsimit (planifikimi shkollor, monitorimi, vlersimi dhe grantet për zhvillimin e shkollës).
-Kujdesi për ruajtjen e ambientit jetësor.
-Kujdes permanent për përmirësimin e kushteve në shkollë si dhe paisjen me mjete mësimore.
-Organizimi i seminareve interne.
-Iniciativ për bashkepunim me shkollat perendimore (Gjermani, Zvicer Austri, Itali) dhe bartja e përvojave në shkollën tonë.
- Ndertimi i 5 klasave të reja që do të çonte në mësim ditor.
- Rrethimi i oborrit të shkollës në SH.P.Siniçan.
- Zgjidhje me sistemin e shkollës në SH.P.Siniçan.
- Ndërtimi I një kabineti për Biologji-Shkenca sepse të gjitha pajisjet.
- Fasad e re për shkollën periferike Sellarce Epërme.
- Realizimi I projektit „Fëmijët ndihmojnë,natyra Falemenderon"
-Ndërtimi I kabinetit t; Bilogjis;/Shkencave sepse t; gjitha mjetet i posedon shkolla për lëndët përkatëse

6. Detyra dhe aktivitete

Në këtë vitë shkollor planifikojmë të kryejmë këto aktivitete (detyra):

Detyra1:

Ndjekja e seminareve nga ana e arsimtarëve e ciklit të ulët dhe ciklit të lartë.
Realizimi do të jetë nga mesi i Gushtit dhe do të vazhdojë deri në Qershor.

Seminar intern te projektit “Paketa e Gjelbert”.
Ndjekja permanente e projektit “ Programet e adaptuara nga kl.I deri të VIII sipas Konceptit të ri”
Bartësit: Byroja për Zhvillimin e Arsimit.
Seminare interne “Marëdhëniet ndëretnike” USAID
Kriteriumi është që arsimtarët të marrin pjesë në këto seminare.

Detyra2:
Organizim i seminarit për arsimtarët e ciklit të ulët dhe të lartë.
Realizimi të jetë kah mesi i Gushtit.
Bartës: Byroja për Zhvillimin e Arsimit..
Kriteriumi është që ky seminar të organizohet nga këta bartës.

Detyra 3
Përfshirja e prindërve në orët praktike të organizuar nga arsimtarët.

Detyra 4
Avansimi dhe trajnimi i anëtarëve të zgjedhur të kolektivit të kryejnë shërbime për të cilat shkolla ka kërkuar njerëz të jashtëm me kompensime jo të vogla. Me trajnimet që rregullisht ofrohen dhe me të njëjtat kompensime, pse mos i kryen këto shërbime dikush nga brenda, që i njeh më mirë se kushdo nga jashtë specifikat e shkollës sonë. Do përmendim: Trajnimet për realizuesin e tenderëve, Trajnimet për projektet Europjane, të IPA Fondeve, Trajnimet dhe kurset e ndryshme për shërbime shtesë për Arkivues, Porositës i Librave, Regjistrues i Inventarit dhe Mjeteve, shërbime që në masë të madhe i mungojnë shkollës dhe nuk kompensohen si duhet, kurse janë të parapara me ligj.

Detyra 5
Parashikimi në buxhet i një fondi për Këshillin e shkollës, reprezentacion, harxhime dhe kompensime për pjesëmarrje në gara që nuk u arritën të mirratohen vitin paraprak shkollor si dhe të gjithë të punesuarve në shkollën tonë tu paguhen vitete jubilare të cilat janë të garantuara me ligj.

7. Organizimi i punës edukativo-arsimore

7.1 MËSIMI

Në vitin shkollor 2026/2027në SHFK “Sabedin Bajrami” do të realizohen këto forma të arsimimit.
Programa vjetore për punën e shkollës parasheh:

Mësimi (tek klasat I dhe VIII sipas Konceptit të ri)
Aktivitetet jashtëmësimore.
Kujdesi për shëndetin e nxënësve.
Bashkëpunimi me mjedisin lokal
Bashkëpunimi me shkollat e etnive tjera
Bashkëpunimi me shkollat tjera
Përcjellja, vleresimi dhe përparimi i punës edukativo-arsimore
Përsosja profesionale e arsimtarëve, drejtorit dhe pedagogut
Planifikimi i punës edukativo-arsimore

7.1.1Mësimi i rregullt

Mësimi i rregullt do të realizohet prej kl .së I-IX-të do të përfshijë këta lëndë mësimore : Gjuhë Shqipe , Gjuhë Maqedone , Gjuhë Angleze, Gj. Gjermane, Histori dhe Shoqëri, Shkathtësitë e jetës, Matematikë, Fizikë, Kimi, Biologji, Histori, Gjeografi, Arsim teknik dhe Informatik, Programim, Arsim Muzikore, Kultura qytetare, Inovacione, Arsim Figurative, AFSH , Shkencat Natyrore, Etika e religjioneve .

Përfshirja e lëndëve mësimore në procesin mësimor nëpër klasë dhe fondi javor i orëve për secilën lëndë mbështeten në planin dhe programën mësimore. Në kl.e pare, të dytë dhe të tretë do të punohet me konceptin e ri nga të gjitha lëndët mësimore, katërtat,pestat,gjashtat , shtatat dhe te tetat gjithashtu do të punohet me konceptin e ri.

Mësimi i rregullt do të realizohet në dy ndërrime në bazë të orarit të përgatitur me kohë, edhe ate në 3 objektet shkollore një në Kamjan dhe në dy objekte në shkollën territoriale në F. Sedllarcë, si dhe një ne F. Siniçan.

Ky vit shkollor vazhdon me aplikim e konceptit të ri prej klasave te I-ra deri te klasat e VIII-ta.

7.1.2 Mësimi zgjedhor.

Në këtë vitë shkollor mësim zgjedhor do të zhvillohet në:
Kl. e IV-ta në lëndën: Gjysëmvjetori i I "Vizatim, pikture skulpurë" dhe Gjysëmvjetori i II "Edukimi për aftësi Jetësore"
KL. e V-ta në lëndën: "Kam të drejtë" dhe " Mbrojtja e Mjedisit Jetësor"
Kl e VI-ta lëndën: Gjysëmvjetori i II "Bletët dhe rolii tyre në ruajtjen e natyrës" dhe
Gjyëmvjetori i I "Etika e religjioneve"
Kl. e VII-ta në Gjysëmvjetorin e I "Bazat e zhv. te Uebit I" Gjysëmvjetori i II "Morali dhe vlerat etike"
Kl e VIII-ta ,,Edukimi për një të ardhme të qendrueshme" dhe ,,Ndihma e Parë"
Kl. e IX-ta "Dizajni grafik" "Bazat e zhvillimit të Uebit II".

7.1.3 Mësimi shtues

Ky lloj mësimi do të organizohet me nxënësit të cilët gjatë mësimit të rregullt tregojne rezultate mbi mesatare në lëndë të ndryshme. Me këtë mësim do të vije në shprehje puna individuale e nxënësve në grupe të vogla , zgjedhja e problemeve të natyrës teorike dhe praktike me organizimin e debateve, eksperimenteve etj.

Ky lloj mësimi do të realizohet në gjysëmvjetorin e I-rë dhe të II-të.

7.1.4 Mësimi plotësuesësi

Mësimi plotësues do të realizohet gjatë tërë vitit shkollor edhe ate nga dy orë në javë dhe do të mbahet me nxënësit të cilë ngecin në procesin mësimor. Mësimi plotësues do të realizohet në kontinuitet,para së gjithash do të aplikohet forma individuale e punës.

7.1.5 Mësimi vazhdues

Ky lloj mësimi do të organizohet me ata nxënës të cilët nuk kanë treguar sukses gjatë vitit shkollor në lëndë të caktuara edhe ate në kl. IV-IX dhe e njejta do të organizohet pas mbarimit të vitit shkollor pas 10.06.2027.

7.2. Aktivitetet jashtëmësimore
Aktivitetet e lira të nxënësve (ALN-së)

Nr.rend.	Lloji i sesionit	nr.i orëve	Realizator
1.	Seksioni letrarë	72	Sherete Rustemi Xhemile Selmani
2.	Seksioni i Gjuhës Angleze	90	Idriz Ismaili

			Ibe Elezi
3.	Dashamirët e natyrës	27	U .e paraleleve të kl.IV
4.	Matematicientët e rinj	144	Sadife D., Merzika Z., Rahim A., Safet I. Valona B.
5.	Biologët e rinj	36	Zeqije Ismaili, Nadie Idrizi
6.	Kimistët e rinj	36	Suada Bexheti
7.	Fizicientët e rinj	36	Qëndresa Sallai
8.	Gjeografët e rinj	36	Bexhet Zulfiu
9.	Historianët e rinjë	72	Liridona Ferati
10.	Shkalla meteorologjike	36	Bexheti Zulfi
11.	Ekologët e rinj	36	Adisa Sherifi

Aktivitetet e lira kulturo- -artistike

Nr.rend.	Lloji i sesionit	nr.i orëve	Realizator
1.	Seksioni recitues	61	Ars. Klasorë; Hirijete Nuredini dhe Elifije H.
2.	Seksioni i dramës	36	Shyrete Rustemi.
3.	Seksioni muzikor	25	Agron Idrizi
4.	Seksioni i artit	72	Afërdita Murati

Aktivitetet e lira teknike

Nr.rend.	Lloji i sesionit	nr.i orëve	Realizator
1.	Seksioni i komunikacionit	36	

Aktivitetet e lira sportive

Nr.rend.	Lloji i sesionit	nr.i orëve	Realizator
1.	Seksioni sportiv	189	Ars.e kl. I -IV
2.	Futbollistët e rinj	36	Elmaz Sinani
3.	Volejbollistët e rinj	36	Hurije Sali, Amet Aliu
4.	Basketbollistët e rinj	36	Asllan Ismaili

Programa për punë të A.L.N-Sesioni i Dramës

Nr.rendor	Aktivitetet	nr.i orëve	koha e realizimit	Realizatorë
1.	Formimi i seksionit të dramës	1	Shtator	Sherete Rustemi Hirijete N.
2.	Analiza teorike e tekstit të dramës	2	Tetor	Xhemile S. Lirije D.
3.	Shiqimi i shfaqjeve teatrore në TV	2	Nëntor	
4.	Vizita e shfaqjeve teatrore	2	Dhjetor	
5.	Zgjedhja humorit për dramatizim dhe realizimi i tij	2	Janar	
6.	Zgjedhja e teksit të dramës	2	Shkurt	
7.	Ushtrime të tekstit të dramës	3	Mars	
8.	Zgjedhja e tekstit të dramës për nder tëpatronatit të shkollës	2	Prill	
9.	Ushtrime të tekstit të dramës	3	Maj	

Programa për punë të A.L.N – Sesioni i Sportit

Nr.rendor	Aktivitetet	nr.i orëve	koha e realizimit	Realizatorë
1.	Formimi i seksionit sportiv	4	Shtator	Amet .A/ Asmir.R Elmaz.S /Zembrej.H Bekim .Z /Asllan.I
2.	Hendboll-udhëheqja dhe gjuajtja			
3.	Përsosja e elementeve të hendbollit			

	Lojra sportive – Volejboll			
5.	Basketboll-udhëheqja dhe gjuajtja e topit	4	Tetor	
6.	Përsosja eelementeve të basketbollit			
7.	Lojra sportive –Basketboll			
8.	Volejboll-pasimi në vend dhe në lëvizje	4	Nëntor	
9.	Përsosja e elementeve të volejbollit			
10.	Lojra sportive-Volejboll			
11.	Gjuajtja me pushk ajrore	4	Dhjetor	
12.	Stërvitje e shënjestrës me pushk ajrore			
13.	Stërvitje-gjuajtje me pushk ajrore			
14.	Valle popullore	2	Janar	
15.	Valle popullore-lojra			
16.	Ping-pong-elementet elementare	4	Shkurt	
17.	Stërvitje të elementeve të ping-pongut			
18.	Lojra sportive –futboll			
19.	Hudhja e gjyles-elementet elementare	4	Mars	
20.	Stërvitje të elementeve të hudhjes së gjyles			
21.	Hudhja e gjyles-nxënësit veçeveç			
22.	Stërvitje e vrapimit të shpejt, starti i ulët dhe i lartë	4	Prill	
23.	Stërvitje e kërcimit në largësi			
24.	Stërvitje e kërcimit në lartësi			
25.	Fotball-elementet elementare	4	Maj	
26.	Stërvitje të elementeve të futbollit			
27.	Lojra sportive –Futboll			
28.	Gara shkollore për nder të patronatit të shkollës	2	Qershor	

Programa për punë të seksionit – Muzicientëte rinj

Nr.rendor	Aktivitetet	nr.i orëve	koha e realizimit	Realizatorë
1.	Formimi i grupit të nxënësve	4	Shtator	Agron Idrizi
2.	Formimi i orkestrit-mandolina			
3.	Vizita e manifestimeve kulturore			
4.	Bashkëpunimi me shkolla të tjera	4	Tetor	
5.	Ushtërime me mandolinë			

6.	Manifestim për nder të 11-Tetorit			
7.	Zbulimi i zërave	4	Nëntor	
8.	Ndëgjimi i muzikës zbavitëse			
9.	Ushtrimi i këngëve			
10.	Vizita e koncerteve			
11.	Përgatitja e programit për Vitin e Ri	4	Dhjetor	
12.	Programa kulturoro-artistik për nder të Vitit të Ri			
13.	Arti i baletit	2	Janar	
14.	Ndëgjimi i muzikës serioze			
15.	Solistët instrumental	4	Shkurt	
16.	Ndëgjimi i muzukës nga radioja			
17.	Bashkëpunimi me shkollat tjera			
18.	Grumbullimi i këngëve për 8-Marsin	4	Mars	
19.	Përgatitja e manifestimit për 8-Marsin			
20.	Manifestimi për 8-Marsin			
21.	Kori i shkollës	4	Prill	
22.	Kënga "Mësuesi"			
23.	Ndëgjimi i muzukës			
24.	Ansambli instrumental	4	Maj	
25.	Ushtërime me korin e shkollës			
26.	Përgatitje për patronatin e shkollës			
27.	Organizimi i vizitave të shkollave tjera			
28.	Ushtërime me nxënësit për nder të patronatit	4	Qershor	
29.	Programa kulturore –artistike për nder të patronatit të shkollës			

Programa për punë të A.L.N – Seksioni Recitues

Nr.rendor	Aktivitetet	nr.i orëve	koha e realizimit	Realizatorë
1.	Formimi i seksionit recitues	1	Shtator	Ars. kl. I-IVFatmire Aliu
2.	Përgatitje për ekspozit të krijimtarive të nxënësve (gazet muri)	2	Tetor	
3.	Rëndësia e poezis epiko –lirike	2	Nëntor	
4.	Vlersimi i krijimtarive të nxënësve	2	Dhjetor	
5.	Jeta dhe vepra shkrimtarëve shqiptar nga	3	Janar	

	sfera e poezis epiko –lirike			
6.	Punë me seksionin recitues për shënime të jubilejeve në shkollë dhe fshat	3	Shkurt	
7.	Zgjedhja e recitalit për patronatin e shkollë	1	Mars	
8.	Ushtrime të recitalit	2	Prill	
9.	Pjesmarja e antarëve të sesionit recitues në festimin e patronatit	1	Maj	
10.	Analiza e punës njëvjeçare të sesionit recitues	1	Qershor	

Programa për punë të A.L.N-të BTP-ës

Nr.rendor	Aktivitetet	nr.i orëve	koha e realizimit	Realizatorë
1.	Formimi i seksionit të BTP-ës	4	Shtator	
2.	Regulla elementare e shkrimit teknik			
3.	Njoftimi me fotografin			
4.	Njoftimi praktik me rrymën elektrike	4	Tetor	
5.	Montimi dhe demontimi i ziles elektrike			
6.	Prodhimi i energjisë elektrike	4	Nëntor	
7.	Njoftimi me elektromotorët dhe gjeneratorët			
8.	Montimi dhe demontimi vinçit	4	Dhjetor	
9.	Montimi i pistols elektrike			
10.	Rregullat dhe dispozitat në trafik	2	Janar	
11.	Solidariteti dhe humaniteti në trafik			
12.	Përpunimi dhe montimi i kampshtëpis	4	Shkurt	
13.	Ndërtimi i urës në trafik			
14.	Ngasja e biçikletës nëpër poligon	4	Mars	
15.	Njoftimi i shenjave të komunikacionit			
16.	Ushtrime me biçiklet	4	prill	
17.	Njoftimi i biçikletës me motor			
18.	Pjesëmarrja në gara regjionale	4	Maj	
19.	Fotografimi i nxnësve			
20.	Përpunimi praktik i fotografive			
21.	Analiza e punës së seksionit të BTP-ës	2	Qershor	

Programa për punë të A.L.N- Matematicientëve

Nr.rendor	Aktivitetet	nr.i orëve	koha e realizimit	Klasa	Realizatorë
1.	Bashkësitë	4		VI	Valona Beadini, Sadife Dauti, Safet Imeri, Rahim Aliu
2.	Relacionet dhe pasqyrimet	4			
3.	Disa lëvizje në rrafsh	3			
4.	Pjestushmëria e numrave natyror	4			
5.	Detyra aritmetike	3			
6.	Thyesat	4			
7.	Barazimet	3		VlI	Merzika Zurapi, ValonaBeadini, Safet Imeri
8.	Sistemet numerike	4			
9.	Bazat e Gjeometrisë	4			
10.	Detyra logjike - kombinatorike	6			
11.	Trekëndëshi dhe katërkëndëshi				
12.	Kontuksione	3			
13.	Syprina e figurave	2			
14.	Detyra logjike	3			
15.	Shprehjet racionale	4			
16.	Trekëndëshi dhe katërkëndëshi	4			
17.	Elemente të teorisë së numrave	4		VIII	Safet Imeri, Valona Beadini, Sadife Dauti
18.	Përdëftimet në gjeometri	3			
19.	Krahasimi i madhësive	3			
20.	Teorema e Pitagorës	4			
21.	Përdëftimet në gjeometri	3			
22.	Proporcionaliteti dhe proporcionet	3			
23.	Vija rrethore dhe shumkëndëshi	4		IX	Rahim Aliu,Valona Beadini, Sadife Dauti,Merzika Zurapi
24.	Barazimet, pabarazimet dhe Barazimet e Diofantit	5			
25.	Ngjajshmëria dhe teorema e Pitagorës				
26.	Vektorët	3			
27.	Funksionet	4			

	Suprina e rrjetës katrore dhe trekëndore	3			
29.	Trupat gjeometrik	3			
30.	Transformimet Algjebrike	3			
31.	Kongruenca në bashkësinë e numrave të plot				

Programa për punë të A.L.N – Gjeografët e rinj

Nr.rendor	Aktivitetet	nr.i orëve	koha e realizimit	Realizatorë
1.	Emri dhe lënda e Gjeografisë	4	Shtator	Bexhet Zulfiu, Hirmize Ferati
2.	Europa (ndarja)			
3.	Emri, kufijt dhe madhësia e Azisë			
4.	Vendëpozita e RMV si shtet Europian dhe Balkanik			
5.	Gjithësia (kuptimi), trupat në gjithësi	4	Tetor	

	Përpunimi i reliefit të Europës			
7.	Përpunimi i reliefit të RMV			
8.	Klima në Europë			
9.	Përpunimi i hartës gjeografike	4	Nëntor	
10.	Numri i lëvizjes së popullsis në RMV			
11.	Struktura themelore e popullsisë			
12.	Paraqitja e reliefit në hartë	4	Dhjetor	
13.	Hidrosfera e Europës			
14.	Mbrojtja e botës bimore dhe shtazore			
15.	Përbërja e mbështjellsit të gurit	2	Janar	
16.	Përpunimi i reliefit të vendlindjes			
17.	Vizita e stacionit meteorologjik	4	Shkurt	
18.	Pasurit natyrore të malit Sharrë			
19.	Burimet energjetike dhe shpërndarja e tyre			
20.	Ndarja e hartave sipas përmbajtjes	4	Mars	
21.	Llogaritja e reliefit në hartë			
22.	Liqejtë në RMV			
23.	Industria e RMV	4	Prill	
24.	Kapaciteti industrial i rrethit tonë			
25.	Zhvillimi i bujqësisë (rrethi i pollogut)			
26.	Zhvillimi i botës shtazore	4	Maj	
27.	Komunikacioni në RMV			
28.	Turizmi në RMV			
29.	Struktura nacionale e popullsisë në RMV	4	Qershor	
30.	Analiza e punës së seksionit gjeografët e rinj.			

Programa për punë të A.L.N – Art.Figurativ

Nr.rendor	Aktivitetet	nr.i orëve	koha e realizimit	Realizatorë
1.	Njoftimi i nxënësve me aktivitetet	4	Shtator	Afërdita Murati
2.	Dekorimi i enterierit të shkollës			
3.	Përgatitja e ekspozitës për nder të 11-Tetorit	4	Tetor	
4.	Kujdes për mirëmbajtjen e përmendoreve			
5.	Vizatimi me tush	4	Nëntor	

6.	Vizatim: Akuarel			
7.	Analiza e veprave artistike	4	Dhjetor	
8.	Dekorime për Vitin eRi			
9.	Përgatitja e ekspozitës për gjysëmvjetor	2	Janar	
10.	Komunikimi vizuel	4	Shkurt	
11.	Njoftim me dizajnim			
12.	Njoftimi me fotografi artistike	4	Mars	
13.	Njoftimi me grafikën			
14.	Punë praktike (pejsazh pranveror) dhe bashkëkohore	4	Prill	
15.	Njoftimi me Arqitekturën e vjetër			
16.	Vizita e galerive artistike, muzeumeve etj.	4	Maj	
17.	Kujdesi për grumbullimin e gjërave me vlerë artistike	2	Qershor	
18.	Analiza e punës së seksionit			

Programa për punë të A.L.N – Sesioni i Historisë

Nr.rendor	Aktivitetet	nr.i orëve	koha e realizimit	Realizatorë
1.	Formimi i grupit të seksionit të Historisë	4	Shtator	Asmir Sallai, Liridona Ferati
2.	Analiza e punës për vitin e kaluar			
3.	Prezentimi i programës për vitin shkollor 2025/26			
4.	Përgatitja e mjeteve mësimore (harta, skica, grafikone etj)	4	Tetor	
5.	Diskutimi i lirë me nxënësit			
6.	Roli i përmendoreve dhe muzeumeve historike në mësimin e Historisë	4	Nëntor	
7.	Kryengritja e përgjithshme shqipëtare (1909-			

	1912)			
8.	Formimi i qeverisë së Ismail Qemalit			
9.	Diskutimi i lirë me nxënësit			
10.	Shiqimi i filmiT në lidhje me ngjarjet e sipërpërmendura historike	4	Dhjetor	
11.	Vizita e përmendoreve Historike			
12.	Diskutimi i nxënësve në lidhje me vizitën			
13.	Analiza e punës gjat gjysëmvjetorit të parë	2	Janar	
14.	Pjesëmarrja e popujve Ballkanike në luftën e parë Botërore	4	Shkurt	
15.	Lufta e përbashkët e shqipëtarëve dhe maqedonëve gjat kryengritjes së Ilindenit			
16.	Diskutimi i lirë me nxënësit			
17.	Lidhja e Prizrenit-Lufta për autonomi	4	Mars	
18.	Abdyl Frashëri-vepra dhe jeta			
19.	Shiqimi i filmit në lidhje me ngjarjet e sipërpërmendura.			
20.	Revolucioni i qershorit- Qeveria e F.S.Nolit	4	Prill	
21.	Shtetet ballkanike në luftën e parë botrore			
22.	Diskutimi i lirë me nxënësit			
23.	Kongresi i Manastirit-1908	4	Maj	
24.	Sami Frashëri –jeta dhe vepra			
25.	Analiza e punës së seksionit gjat vitit shkollor	2	Qershor	

Garat shkollore.

Nëpërmjet garave shkollore do të përfshihen aktivitete me të cilat do të prezentohen të arriturat e nxënësve në proçesin mësimor dhe aktivitete tjera në shkollë, të njejtat do të kenë për qëllim zhvillimin e personalitetit të nxënësit dhe interesin e tij për njohuri të reja nga lëmitë e shkencës, kulturës, teknikës, sportit etj, gjithashtu nëpërmjet të këtyre aktiviteteve nxënësit do të vijne deri te shoqërimi me nxënës nga vendet tjera.

Në bazë të nivelit të mbajtjes garat do të jenë: shkollore, regjionale, republikane dhe ndërkombëtare.

Garat shkollore do të organizohen në disa lëndë për të cilat do të organizohen gara komunale dhe regjionale, do të jenë në disa forma :

-Gara në mes nxënësve në paralele.

-Gara në mes ekipeve në nivel të klasave. - Gara në mes nxënësve dhe ekipeve në nivel të shkollës. Nga format e garave të lartpërmendura nxënësit dhe ekipet më të suksesshme do të përcjellen në garat komunale dhe regjionale.

Programa për punë prodhuese dhe punë të tjera të dobishëme shoqërore

Ky lloj i aktiviteteve me nxënësit do të realizohet në mjedisin lokal ku nxënësit do të marrin pjesë në aksione të ndryshme do të marrin pjesë në rregullimin dhe mirëmbajtjen e objektit të shkollës, mësojtores dhe

rrethinës së afërt.

Udhëheqësit e këtyre aktiviteteve do të jen udhëheqësit e paraleleve dhe do të realizohennëpërmjet këtyre aktiviteteve:

1. Mirëmbajtja e oborrit dhe rrethinës së afërt të shkollës.
2. Kultivimi i përgjegjësisë tek nxënësit gjatë punës.
3. Mirëmbajtja dhe rregullimi estetik i mësojtoreve.
4. Grumbullimi i mjeteve materiale për vendet e kapluara nga fatëkeqësitë elementare.
5. Kujdesi për pamjen e jashtme dhe të brendshme të shkollës.
6. Ndihmë personave të rrezikuar.
7. Pyllëzimi i vendeve të zhveshura në afërsi të shkollës.
8. Pjesëmarrje në akcionet punuese të organizuara nga Bashkësia lokale.
9. Krijimi i shprehive për mirëmbajtjen e pastërtisë dhe higjienës në shkollë.
10. Bashkëpunimi me institucionet tjera.

Këto aktivitete do të realizohen permanent gjatë tërë viti

Bashkësia e nxënësve

Në SHFK "Sabedin Bajrami" Bashkësia e nxënësve është segment me rëndësi përmes së cilës nxënësit zgjedhin problemet që lindin në paralele dhe tek disa nxënës propozojnë ide për përmirësimin e kushteve në shkollë etj.
Bashkësia e nxënësve organizohet në të gjitha paralelet.
Për realizimin e të drejtave të veta nxënësit organizohen në:

-Bashkësia e nxënësve të paraleles dhe

-Bashkësia e nxënësve në shkollë.

Si organ më i lartë për udhëheqës në suaza të bashkësisë së nxënësve në paralele si dhe në nivel të shkollës është kryesia e bashkësisë së nxënësve.

Kryesia përbëhet nga tre anëtar edhe ate:

1.Kryetari
2. Sekretari
3. Arkëtari

Bashkësia e nxënësve në nivel të paraleles delegon nga një anetar në bashkësin e nxënësve në nivel të shkollës, ku bëhet zgjedhja e kryesisë së bashkësisë së nxënësve në nivel të shkollës e cila përbëhet nga:

1.Kryetari
2.Sekretari
3. Arkëtari
4. Anetar
5. Anetar.

Programa për punë të bashkësisë së nxënësve në nivel të shkollës

*Përmbajtja e aktiviteteve

1. Mirëmbajtja e rendit dhe disciplinës në shkollë.
2. Ruajtja e inventarit të shkollës
3. Lufta kundër shprehive negative në shkollë dhe jashtë saj.
4. Zgjedhja me kohë e problemeve eventuale në paralele dhe shkollë.
5. Pjesëmarrja në të gjitha aktivitetet në shkollë.
6. Shqyrtimi i suksesit në nivel të paraleles dhe në shkollë.

7. Ndihma nxënësve të cilët ngecin në mësim.
8. Organizimi i ekskursioneve dhe angazhimi për sjellje të mirë të nxënësve gjatë tyre.
9. Mbrojtja e ambientit jetësor.
10. Sigurimi i ndihmave materiale për nxënësit që kanë nevojë për ta.

Të gjitha këto aktivitete në mënyrë permanente do të realizohen gjatë tërë vitit, kurse bartës do të jetë kryesia e bashkësisë së nxënësve dhe anetarë tjerë.

7.3. Kujdesi për shëndetin e nxënësve

SHFK "Sabedin Bajrami" në bashkëpunim me prindërit, organizatat shëndetësore dhe bashkësinë më të gjërë ka për obligim kujdesin për shëndetin e nxënësve, disa çështje konkrete nga kjo lëmi do të përfshihen gjatë mësimit të rregullt në disa lëndë mësimore, si dhe në orën e klasës.

Shkolla kujdesin për shëndetin e nxënësve do ta realizoi edhe nëpërmjet të shiqimeve të rregullta mjeksore, stomatollogjike, vakcimimin e nxënësve etj.

Gjatë vitit shkollor 2026/27 do të realizohen këto aktivitete:

1. Ligjerata ma karakter shëndetësor (Dr. Nadir Ajruli)
2. Shprehit për pastërti në familje, bartja e të njejtave në shkollë.
3. Mbajtja e higjienës në shkollë është obligim i nxënësve.
4. Ushqimi i rregullt është kusht për shëndet të mirë.
5. Vakcinimi dhe rivakcinimi i nxënësve
6. Kontrollimet e rregullta mjeksore të nxënësve. Kl. III-V-VII
7. Kontrollimet e rregullta stomatollogike. Nga kl. I deri tek e VIII
8. Marrja e masave preventive kundër epidemive të ndryshëme.
9. Organizimi i dimërimeve, verimeve dhe pikniqeve të nxënësve.
10. Kujdesi rreth paraqitjes së dukurive negative.

Bartës të këtyre aktiviteteve do të jenë: Shkolla me të gjithë kuadrin arsimor, prindët, Punkti shëndetësor në F.Kamjan,kurse aktivitetet do të realizohen në mënyrë permanente gjatë tërë vitit shkollor.

7.4. Bashkëpunimi me bashkësitë vendore

Si gjithmonë SHFK "Sabedin Bajrami" në forma të ndryshme do të bashkëpunoj me mjedisin lokal, ky bashkëpunim si zakonisht përfshinë:

